

### AMF këshillon qytetarët për policat kufitare

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-qershor 2019
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2019

#### Zhvillime të tjera

- Publikohet Raporti i plotë i ekipit të Misionit të Dytë të Monitorimit pas Programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri
- AMF organizon kolegjin e tretë mbikëqyrjes të grupit të sigurimeve
- Seminar mbi zbatimin e politikave në standardet ndërkombëtare, si dhe implikimet e kujdesshme
- Zhvillohet Konferenca mbi Kapitalin Intelektual
- AMF thellon bashkëpunimin me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve Sllovene
- AMF zhvillon trajnim për raportimin financiar

#### Edukimi i Konsumatorit

- Vite të rëndësishme përpara për IAIS (pjesa e dytë dhe e fundit)

#### Botime Profesionale

#### Lajme Ndërkombëtare

- Britani
- Evropa Qendrore dhe Juglindore
- Greqi
- EIOPA

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## AMF këshillon qytetarët për policat kufitare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare këshillon qytetarët që udhëtojnë drejt Shqipërisë me automjetet e tyre me targa të huaja të presin policat kufitare vetëm në pika të autorizuar dhe nga agjentë të licencuar. Në çdo pikë të kalimit të kufirit brenda territorit shqiptar gjenden agjentë të shoqërive të sigurimit pranë të cilave mund të pajiseni me policat kufitare.

Autoriteti i  
Mbikëqyrjes  
Financiare këshillon  
qytetarët që  
udhëtojnë drejt  
Shqipërisë me  
automjetet e tyre me  
targa të huaja të  
presin policat kufitare  
vetëm në pika të  
autorizuara dhe nga  
agjentë të licencuar.

SERIAL: | REGJISTRUAR ME: 1:14PM | PRINTUAR ME: 1:14PM | AGJENTI: DEGA TIRANE

Logo e Shoqërise

Nr. i serisë 19XXXXXXX

KOD RAPORTIMI  
C0E24818C0CFE585D0EB2D1F653467B72

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

**POLICË SIGURIMI KUFITARE**  
*BORDER INSURANCE POLICY*

I SIGURUARI / INSURED ADRESA / ADDRESS TEL.

PËRDORUESI I MJETIT MOTORIK / DRIVER

Emri Mbiemri Name Surname	Gjinia Sex	Datëlindja Date of Birth	Dëshmi aftësie Driving licence	Adresa/Telefoni Address/Phone

Këta agjentë janë miratuar nga AMF dhe punojnë për shoqëritë e sigurimit për shitjen e policave kufitare. Çdo policë e sigurimit kufitar që mund t'iu ofrohet pa hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo që është e plotësuar me shkrim dore dhe jo me mjete elektronike, është në kundërshtim me rregullat e legjislacionit shqiptar, dhe si e tillë është e pavlefshme. Që një policë kufitare të jetë e vlefshme, ajo duhet të figurojë në regjistrin online në faqen zyrtare të AMF-së. Elementët e sigurisë që duhet të ketë Polica Kufitare janë:

Numri i serisë së policës është unik dhe duhet të fillojë me dy shifrat e fundit të vitit aktual. (Shembull: Viti 2019 = 19xxxxxx). Polica e sigurimit kufitar është e shkruar në format elektronik dhe në asnjë rast me shkrim dore. Polica ka një numër unik identifikues në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik me elementë sigurie të gjeneruar nga sistemi i shitjes së policave.

Raportimi dhe identifikimi i policave kufitare të shitura nga kompanitë e sigurimit bëhet në kohë reale nëpërmjet regjistrin elektronik online të shitjeve. Këtë mund ta bëjnë nëpërmjet faqes zyrtare të Autoritetit, [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al), në rubrikën "Verifikoni Policën tuaj", duke ndjekur gjithë hapat e nevojshëm, ose duke dërguar me SMS numrin e targës tuaj në numrin e celularit +355694060671.

Për çdo problem që mund t'ju lindë në lidhje me policën, lutemi të kontaktoni në adresën [konsumatori@amf.gov.al](mailto:konsumatori@amf.gov.al) ose të na shkruani në inbox-in e faqes tonë në Facebook. AMF i bën thirrje qytetarëve të tregohen të kujdesshëm dhe të verifikojnë policën e tyre kufitare për të mos rënë pre e mashtrimeve të ndryshme.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-qershor 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor kapën vlerën mbi 8,095 milionë lekë, ose 5.03% më shumë se në periudhën janar-qershor 2018. Gjatë periudhës janar-maj 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 591,387 me një rritje 4.24% krahasuar me periudhën janar-qershor 2018. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.98% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.54% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.48%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.56% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.44% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,779 milionë lekë, ose 6.69% më shumë se në periudhën janar-qershor 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor kapën vlerën mbi 8,095 milionë lekë, ose 5.03% më shumë se në periudhën janar-qershor 2018.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2019




## Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2019

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2019 u dominua në masën 58.26% në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe pjesa tjetër prej 41.74% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 85.36% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2019 flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 45.83% dhe 35.04% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.39% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

### Letra me vlerë të Qeverisë janar-qershor 2019



#### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2019, ka pasur një rritje prej 691 milionë lekë ose 23.96% krahasuar me periudhën janar-qershor 2018. Ndërkohë numri i transaksioneve është ulur në masën 25.32%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2019, ka pasur rritje prej 250 milionë lekë ose 23.74% dhe gjithashtu, një rritje në numrin e transaksioneve në masën 18.91%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.39% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

## Publikohet Raporti i plotë i ekipit të Misionit të Dytë të Monitorimit pas Programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri

Në përmbyllje të misionit të dytë të monitorimit, delegacioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri nënvizon se perspektiva ekonomike është përgjithësisht e favorshme. Raporti thekson se gjatë vitit 2018, rritja ishte e fortë dhe se perspektiva afatmesme ekonomike është përgjithësisht e favorshme, me rritjen e parashikuar për të konverguar në 4% për qind, duke sjellë edhe ngushtim të mëtejshëm të defiçitit të llogarisë korente.

Duke folur për sektorin financiar jobankar Raporti vlerëson punën e bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për plotësimin e përditësimin e kuadrit ligjor rregullator, ku nënvizon progresin e bërë në tregun e kapitalit, si edhe tregun e fondeve të investimeve. Gjithashtu, cilësohet puna në vijim, gjatë vitit 2019, për hartimin e projektligjit të ri “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, dhe projektligjit të ri “Për Tregjet e Kapitalit”, duke u bazuar në rregulloret e BE-së dhe duke qartësuar licencimin, mbikëqyrjen, mbrojtjen e investitorit, si dhe integritetin e tregut.

Në raportin e tij, misioni i FMN, theksoi rëndësinë e sigurimit të mbikëqyrjes së fortë dhe të pavarur të sistemi financiar jobankar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), “... i cili është duke përgatitur në mënyrë progresive kuadrin rregullator të nevojshëm.”

Në lidhje me rekomandimin e FMN për vijimin e reformave në adresimin e rekomandimeve të komitetit MoneyVal në aspektin rregullativ për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, AMF informon se ka kryer ndryshimet rregullative të nevojshme për të siguruar përputhshmëri me këto rekomandime.

Raportin e plotë të ekipit të Misionit të Dytë të Monitorimit pas Programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri gjendet në:

<https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2019/07/03/Albania-Second-Post-Program-Monitoring-Discussions-Press-Release-and-Staff-Report-47082?cid=em-COM-123-39111>

—○○○—  
Duke folur për sektorin financiar jobankar Raporti vlerëson punën e bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për plotësimin e përditësimin e kuadrit ligjor rregullator, ku nënvizon progresin e bërë në tregun e kapitalit, si edhe tregun e fondeve të investimeve.



## AMF organizon kolegjin e tretë mbikëqyrjes të grupit të sigurimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më 5 korrik në Tiranë “Kolegjin e Tretë të Grupit të Sigurimeve”. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe përfaqësues të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut (ISA). Organizimi i këtij kolegji mbikëqyrës bëhet në zbatim të Strategjisë 2018-2022 të AMF-së për zhvillimin e tregjeve si edhe Vendimit të Bordit nr. 250, datë 28.12.2018, për miratimin e Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”.



*Gjatë zhvillimit të mbledhjes së kolegjit mbikëqyrës*

Në takim u prezantua situata financiare dhe zhvillimet më të fundit nga përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të tre vendeve: AMF, ISA dhe BQK. Në takim u diskutuan edhe raportet e audituesve të jashtëm për vitin financiar 2018 si dhe zhvillimet e reja në tregjet e sigurimeve të rajonit.

AMF dhe rregullatorët e vendeve të tjera të kolegjit, ISA dhe BQK u shprehën për vazhdimësinë e shkëmbimeve periodike 3 mujore të të dhënave lidhur me treguesit e shoqërive të sigurimit anëtare të Grupeve të Sigurimit. Po ashtu u ra dakord për njoftime reciproke për çdo zhvillim të rëndësishëm, duke përfshirë edhe masat e marra nga Bordet përkatëse në ndihmë të zhvillimit e konsolidimit të tregut të sigurimeve dhe në funksion të një mbikëqyrjeje financiare sa më efektive. Autoritetet, pjesë e kolegjit mbikëqyrës, do të organizojnë edhe inspektime të përbashkëta pranë shoqërive të sigurimit, pjesë të grupit të sigurimit, të rregulluara nën juridiksionin e palës pritëse.

AMF dhe kolegjet mbikëqyrëse të grupeve ndjekin parimet themelore të sigurimeve (ICP) të krijuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Synimi i Autoritetit edhe për mbikëqyrjen e grupeve është promovimi dhe nxitja e standardeve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve.

AMF dhe rregullatorët e vendeve të tjera të kolegjit, ISA dhe BQK u shprehën për vazhdimësinë e shkëmbimeve periodike 3 mujore të të dhënave lidhur me treguesit e shoqërive të sigurimit anëtare të Grupeve të Sigurimit.

## Seminar mbi zbatimin e politikave në standardet ndërkombëtare, si dhe implikimet e kujdesshme

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (FSI) zhvilluan në datat 9–10 korrik në Bazel, Zvicër, seminarin “Mbi zbatimin e politikave në standardet ndërkombëtare si dhe implikimet e kujdesshme”. Në këtë aktivitet morën pjesë mbikëqyrës të rreth 30 vendeve të ndryshme të Botës. Temat më të rëndësishme që u trajtuan gjatë zhvillimit të seminarit ishin:

- Kalimi nga SNRF 4 tek SNRF 17 dhe ndikimet e mundshme;

SNRF 17 synon të përmirësojë ndjeshëm krahasimin e rezultateve financiare midis shoqërive të sigurimit. U diskutuan ndryshimet kryesore midis standardit paraardhës SNRF 4 dhe SNRF 17, duke u përqendruar në dallimet e termave e koncepteve, praktikave, si dhe ndryshimet e propozuara në SNRF 17.

- FSI-FMN mbi standardet e kontabilitetit dhe vlerësimin e aftësisë paguese të siguruesit;

- Vështirësitë e zbatimit të SNRF 17;

Zbatimi i SNRF 17 kërkon ndryshime në shumë aspekte që variojnë nga mendimi tek praktikat e reja të kontabilitetit, auditimit dhe aktuaristikës, si dhe sistemet e TI-së. Roli i kontabilitetit profesional, auditimit dhe organeve aktuariale ka një rol të rëndësishëm në promovimin e qëndrueshëm të zbatimit të standardit.

- Përdorimi me kujdes i standardeve të kontabilitetit, si dhe një bisedë në nivel shtetesh lidhur me përgatitjet për zbatimin e SNRF 17;

Pjesëmarrësit e takimit diskutuan mbi aftësinë juridike mbi zbatimin e SNRF 17 për raportim financiar, me qëllim vlerësimin e aftësisë paguese.

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (FSI) zhvilluan në datat 9–10 korrik në Bazel, Zvicër, seminarin “Mbi zbatimin e politikave në standardet ndërkombëtare si dhe implikimet e kujdesshme”.

## Zhvillohet Konferenca mbi Kapitalin Intelektual në Paris

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në edicionin e 15-të të Konferencës Botërore mbi Kapitalin Intelektual “Inteligjenca artificiale dhe gjenerata e ardhshme e kompetencave në punë”. Aktiviteti bashkëorganizohej nga Universiteti Paris-Sud, i cili mban kryesimin në KE për Kapitalin Intelektual dhe Programi Ndërqeveritar i UNESCO-s (IFAP).

Konferenca u zhvillua në Paris, gjatë datave 11-12 Korrik 2019 dhe mblodhi bashkë përfaqësues të institucioneve publike dhe private dhe ato ndërkombëtare (OECD, Banka Botërore, UNESCO, ITO etj.), për të shkëmbyer ide dhe eksperiencë për çështje që lidhen me kompetencat në punë, ndikimin e transformimit digjital, si edhe edukimin në këto drejtime.

Gjatë konferencës u diskutua mbi analizën e profilit të kompetencave në punë si një mënyrë e rëndësishme për të përcaktuar profilet e punës. Një raport i kohëve të fundit (McKinsey, 2018) ka treguar këto tendenca:

1. Rënie në aftësitë fizike dhe manuale gjatë periudhës 2002-2030 (nga 33% në 26%);
2. Rënie në pjesën e përfitimit të njohurive bazike (nga 20% në 15% respektivisht);
3. Asnjë ndryshim domethënës në përfitimin e njohurive më të thelluara (rreth 22%); si dhe
4. Një rritje në pjesën që i përket aftësive sociale, emocionale dhe teknologjike.

Konferenca shqyrtoi kompetencat në punë nga këndvështrime të ndryshme: ato gjeografike (Azia, Evropa, Amerika Veriore dhe Jugore dhe Afrika), institucionale (kompani të mëdha, institucione të mëdha ndërkombëtare, kompani të vogla) dhe profesionale (akademikë, politikëbërës dhe vendimmarrës të sektorit publik e privat).

Kërkesa për aftësitë e mëposhtme pritet të rritet (deri në vitin 2022): të menduarit analitik dhe risitë; strategjitë aktive të të mësuarit; krijimtaria, origjinaliteti dhe iniciativa; dizajnimi dhe programimi i teknologjisë; të menduarit kritik dhe analiza; zgjidhja komplekse e problemeve; lidhshipi dhe ndikimi social; inteligjenca emocionale; arsyetimi, zgjidhja e problemeve dhe ideimi i tyre, si dhe analiza dhe vlerësimi i sistemeve.

Gjatë konferencës u diskutua mbi analizën e profilit të kompetencave në punë si një mënyrë e rëndësishme për të përcaktuar profilet e punës.



Në të njëjtën kohë, kërkesa për aftësitë e mëposhtme pritet të zbresë: zhdërvjelltësia manuale, qëndrueshmëria dhe saktësia; kujtesa, aftësitë verbale; menaxhimi i burimeve financiare dhe materiale; instalimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë; leximi, shkrimi dhe dëgjimi aktiv; menaxhimi i personelit; kontrolli i cilësisë dhe ndërgjegjësimi për sigurinë; koordinimi dhe menaxhimi i kohës; aftësitë vizuale, kontrolluese dhe të folurit; përdorimi i teknologjisë, monitorimi dhe kontrolli (WEF, 2018).

Këto tregojnë se përveç teknologjisë, në të ardhmen do të shohim rritje të kërkesës për ato kompetenca që lidhen me emocionet, ndërveprimin shoqëror dhe kreativitetin, ndërsa detyrat fizike dhe ato që kërkojnë shkathtësi si psh: leximi dhe shkrimi pritet të ulen.

Gjatë konferencës u diskutua edhe mbi rëndësinë e ndërveprimit mes burimeve njerëzore dhe inteligjencës artificiale, dhe mënyra se si ato do të ndikojnë në kompetencat dhe profilet e punës. Gjithashtu se si institucione të ndryshme, publike dhe private përfshirë edhe ato të arsimit universitar dhe pasuniversitar, të edukojnë dhe përgatisin njerëzit duke ofruar mundësi për të fituar këto kompetenca..

### **AMF thellon bashkëpunimin me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve Sllovene**



*Momente nga takimi*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Drejtori i Mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve të AMF-së zhvilluan në datë 18 korrik 2019 takime me drejtuesit e Agjencisë së Mbikëqyrjes të Tregut të Sigurimeve të Sllovenisë, (AZN).

Takimet u zhvilluan në kuadër të Strategjisë së AMF-së 2018-2022, objektivit të rëndësishëm që AMF ka për konsolidimin e tregut të sigurimeve dhe proceseve integruese drejt Bashkimit Evropian. Bashkëpunimi midis dy organizmave rregullatorë të Shqipërisë dhe Sllovenisë është institucionalizuar në vitin 2016 edhe me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.

Z. Ervin Koçi falenderoi për mikpritjen dhe organizimin e takimit homologun Z. Gorazd Cibej, Drejtor i AZN dhe theksoi se shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi janë të rëndësishëm për të ndjekur ecurinë dhe dinamikën e shpejta që shoqërojnë zhvillimet në tregun e sigurimeve. Shqipëria është në prag të marrjes së hapjes së negociatave për anëtarësimin në BE dhe në këtë drejtim eksperiencën e Sllovenisë, e cila e ka kaluar më parë këtë proces, është mjaft e vlefshme.

Në takim të dy drejtuesit e institucioneve bënë një prezantim të detajuar të tregut lokal të sigurimeve dhe vlerësuan mundësinë e mbështetjes teknike dhe shkëmbimit të informacionit për të forcuar rolin mbikëqyrës dhe rregullator në tregun e sigurimeve. AMF synon të përfitojë sa më shumë nga eksperiencat më të mira të Autoritetit Slloven si në drejtim të plotësimit të kuadrit rregullator dhe përshtatjes së tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian ashtu edhe për fuqizimin e rolit mbikëqyrës të tregut të sigurimeve. Një drejtim i rëndësishëm ku AMF kërkoi bashkëpunimin e autoritetit slloven AZN ishte edhe zhvillimi i teknologjisë së informacionit, mbrojtja konsumatore dhe rritja e edukimit financiar për të përgatitur tregun shqiptar të sigurimeve për aplikimin e regjimit të Solvency II, sipas standardeve të tregut evropian të sigurimeve.

Z. Koçi pati takim dhe me drejtuesen e Shoqatës Sllovene të Sigurimit Znj. Maja Krumberger ku u shikuan mundësitë e bashkëpunimit dhe përfshirjes së investimeve sllovene në tregun shqiptar të sigurimeve.

AMF po thëllon bashkëpunimin me rregullatorët e tregjeve financiare jobankare në rajon e më gjerë, për t'i paraprirë zhvillimeve të këtyre tregjeve drejt perspektivës së përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian.

Në takim të dy drejtuesit e institucioneve bënë një prezantim të detajuar të tregut lokal të sigurimeve dhe vlerësuan mundësinë e mbështetjes teknike dhe shkëmbimit të informacionit për të forcuar rolin mbikëqyrës dhe rregullator në tregun e sigurimeve.

## AMF zhvillon trajnim për raportimin financiar



*Momente nga trajnimi*

Në datat 23 dhe 24 korrik u zhvillua në AMF trajnimi për raportimin financiar dhe elementët e tij, i fokusuar në tregjet nën mbikëqyrje. Gjatë ditës së parë të trajnimit u trajtuan kryesisht specifikat e raportimit financiar të shoqërive të sigurimit dhe elementët që duhet të kenë parasysh specialistët e mbikëqyrjes në Autoritet lidhur me këto raportime.

Ditën e dytë ishin specialistët e departamentit të tregut të kapitaleve, të cilët u trajnuan për veçantitë në raportimin financiar për tregjet që ata mbikëqyrin, duke e lidhur këtë edhe me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, IFRS. Trajnimi u zhvillua nga ekspertë ndërkombëtarë, si pjesë e projektit “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar”, mbështetur nga Banka Botërore.

---

Në datat 23 dhe 24 korrik u zhvillua në AMF trajnimi për raportimin financiar dhe elementët e tij, i fokusuar në tregjet nën mbikëqyrje.

---

## Vite të rëndësishme përpara për IAIS

Fjala hyrëse e Jonathan Dixon, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në seminarin "Progres" të zhvilluar në 28 shkurt 2019. Seminari është bërë në vitin kur IAIS mbush 25 vite nga krijimi. Gjatë kësaj periudhe IAIS është shndërruar në organizmin global të përcaktimit të standardeve për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe, duke bashkëpunuar me grupet e interesit, ka ndërtuar një komunitet global për diskutimin e sfidave dhe mundësive për mbikëqyrësit e sigurimeve dhe industrinë e sigurimeve.

(Pjesa e dytë dhe e fundit, me shkurtime dhe redaktime)

### 2. Orientimi drejt zbatimit

Ndërsa punojmë për të finalizuar këto standarde, ne do të mbështesim zbatimin e tyre, si edhe të praktikave efektive mbikëqyrëse. Mbështetja dhe të kuptuarit e materialit tonë mbikëqyrës ka qenë gjithmonë një pjesë e rëndësishme e punës së IAIS-it. Ne do të forcojmë më tej vlerësimin e ecurisë së zbatimit, duke përfshirë edhe komponentët cilësorë të *ComFrame*.

### 3. Përballja me sfidat, rreziqet dhe mundësitë e tendencave që po lindin

IAIS do të vazhdojë të shikojë përpara dhe të ndihmojë në formimin e përgjigjeve mbikëqyrëse ndaj peisazhit në zhvillim të sigurimeve për çështje të tilla si FinTech, rreziku kibernetik, rreziku i ndryshimeve klimatike dhe financimi i qëndrueshëm. Fokusi ynë do të jetë në drejtim të praktikave efektive mbikëqyrëse, më shumë se sa në drejtim të vendosjes së standardeve të reja. Më lejoni t'ju përditësoj për punën e rëndësishme të bërë deri tani dhe axhendën tonë drejt së ardhmes.

#### FinTech

Kohët e fundit kemi krijuar një forum FinTech për mbikëqyrësit për të shkëmbyer perspektiva dhe nxitur zhvillimin e udhëzuesve mbikëqyrës. Disa njohuri kyçe kanë dalë tashmë nga temat e diskutuara në Forum, p.sh. "përdorimin e burimeve të jashtme", përdorimi i "teknologjisë rregullatore dhe mbikëqyrëse" dhe "përdorimi i të dhënave etike në një epokë të të dhënave të mëdha". Forumi po diskuton aktualisht si të fillojë përfshirja e palëve të interesuara në diskutimet e tij dhe ne do t'ju informojmë së shpejti.

#### Rreziku Kibernetik

Vitin e kaluar ne përfundam Dokumentin e Zbatimit në praktikat mbikëqyrëse për të menaxhuar elasticitetin kibernetik në sektorin e sigurimeve. Vëmendja jonë tani është zhvendosur në anën tjetër të monedhës: siguruesit që marrin rrezikun kibernetik përmes sigurimit të posaçëm për këtë kategori. Interesi ynë si mbikëqyrës është të sigurojmë që ky biznes kibernetik të bëhet në mënyrë të qëndrueshme - dhe ne kemi krijuar një grup për të eksploruar rolin e mbikëqyrësve të sigurimeve në këtë drejtim, duke përfshirë edhe rrezikun kibernetik. Sërish, edhe kjo është një çështje për të cilën do të kërkojmë informacion nga grupet e interesit.

Fokusi ynë do të jetë në drejtim të praktikave efektive mbikëqyrëse, më shumë se sa në drejtim të vendosjes së standardeve të reja.

— COO —  
Është e qartë se industria e sigurimeve do të luajë një rol kritik në tendencat kryesore dhe sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria në vitet në vijim.  
— COO —

### **Rreziku i ndryshimeve klimatike**

Së bashku me Forumin e Sigurimit të Qendrueshëm (SIF), ne botuam vitin e kaluar, dokumentin tonë të parë lidhur me rreziqet e ndryshimeve klimatike në sektorin e sigurimeve. Vëmendja tani është përqendruar në veprimet tona, duke përdorur rekomandimet e Bordit të Stabilitetit Financiar. IAIS dhe SIF po punojnë për hartimin e një dokumenti, për të rritur ndërgjegjësimin në dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me klimën, përdorimin e skenarëve, parametrave, zhvillimin e praktikave më të mira, të cilat duhet të konsiderohen nga siguruesit.


### **Financat e qendrueshme**

IAIS ka vendosur të shqyrtojë çështjen nëse duhet të ketë një trajtim të diferencuar për investimet kualifikuese të infrastrukturës në ICS. Puna jonë do të konsiderojë asetet e dhura, përkufizimet e përshtatshme, grumbullimin e të dhënave të nevojshme për të evidentuar performancën dhe nëse përshtatjet e kërkesave të kapitalit të standardizuara mund të justifikohen. Ne planifikojmë të përcaktojmë se çfarë do të sjellë kjo saktësisht dhe kohën e fazave të ndryshme të punës që do të duhen.

Në përfundim, është e qartë se industria e sigurimeve do të luajë një rol kritik në tendencat kryesore dhe sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria në vitet në vijim. Kjo kohë është sfiduese, por edhe emocionuese për IAIS. Si komunitet i mbikëqyrësve, ne e pranojmë nevojën e përpjekjes bashkëpunuese me të gjitha grupet e interesit.

## JOURNAL OF PENSION ECONOMICS & FINANCE

Volumi 18, korrik 2019 përmban këto shkrime kryesore:



- Çfarë mendoni se mund t'ju dëmtojë: rreth besimit në njohuritë financiare dhe gatishmërinë për daljen në pension  
*(What you think you know can hurt you: under/over confidence in financial knowledge and preparedness for retirement (Marco Angrisani, Maria Casanova)*
- Efektet e rishpërndarjes së sistemeve të pensioneve dhe krahasimet e vlerave të sigurimeve shoqërore. Çfarë mësojmë  
*(What do we learn about redistribution effects of pension systems from internationally comparable measures of Social Security Wealth? (Michele Belloni, Agar Brugiavini, Raluca E. Buia, Ludovico Carrino, Danilo Cavapozzi, Cristina E. Orso, Giacomo Pasini)*
- Fuqia e të punuarit për një kohë më të gjatë  
*(The power of working longer (Gila Bronshtein, Jason Scott, John B. Shoven, Sita Nataraj Slavov)*

## GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, korrik-gusht 2019 përmban këto shkrime kryesore:



- Monedha *Libra* e Facebook-ut mund të sjellë rishikim të kuadrit rregullator  
*(Facebook's Libra may force rethink of regulatory frameworks)*
- Procesi i dixhitalizimit tregon pikat delikate të sistemit rregullator dhe teknologjik  
*(Digitisation shows regulatory and technological hotspots)*

## **Britani, skemë sigurimi për banesat në rrezik përmbytjeje**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Vlerësohet se rreth 5.3 milionë banesa në Britani janë në rrezik nga përmbytjet. Gjithçka përkthehet në kosto shtesë për siguresit, si pasojë e rrezikut të shtuar nga katastrofat natyrore dhe kjo ka sjellë një rritje të primeve të sigurimit për këto banesa. Në kushte të tilla, qeveria britanike, në bashkëpunim me një shoqëri risigurimi kanë ofruar një skemë lehtësuese sigurimi për të gjithë pronarët e këtyre banesave.

## **EIOPA publikon manuale për qeverisjen dhe menaxhimin e rrezikut të Fondeve të Pensionit**

[www.eiopa.europa.eu](http://www.eiopa.europa.eu)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) publikoi më 10 korrik 2019 katër manuale për të asistuar autoritetet rregullatore në nivel kombëtar në zbatimin e masave për Institucionet e Pensioneve Profesionale, Direktiva IORP II. Qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut të skemave të pensioneve janë thelbësore për të mbrojtur anëtarët e skemave të pensionit.

Në lidhje me publikimet, Gabriel Bernardino, drejtues i EIOPA-s, u shpreh: "Direktiva IORP II ka lidhje të thella me qeverisjen dhe menaxhimin e rrezikut të fondeve të pensioneve profesionale në Evropë. Në këtë kontekst, manualët e EIOPA-s janë një themel për mbikëqyrjen në të ardhmen, duke e kombinuar këtë me vetëvlerësimin e rrezikut të fondeve të pensioneve, për një mbrojtje më të mirë të anëtarëve dhe përfituesve."

## **EIOPA hap konsultime për harmonizimin e skemave kombëtare të garancive në sigurime**

[www.eiopa.europa.eu](http://www.eiopa.europa.eu)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) nisi më 10 korrik 2019 konsultimet në lidhje me udhëzimin e tij për harmonizimin e skemave kombëtare të garancive në sigurime mes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. EIOPA sugjeron që çdo vend anëtar të ketë në funksion një skemë kombëtare të garancisë, për mbrojtjen e policëmbajtësve, në rastin e falimentimit të një siguresi. Për këtë arsye, EIOPA ka kërkuar krijimin e një rrjeti evropian të skemave kombëtare të garancive në sigurime, që të jenë mjaftueshëm të harmonizura dhe të financuara në mënyrën e duhur.

## Evropa Qendrore dhe Juglindore

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Juglindore e mbylli 3-mujorin e parë të vitit 2019 me 10.1 miliardë euro prime të shkruara bruto, me një rritje mesatare prej 2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 3.2 miliardë euro, me një rënie prej 5.3%. Kjo për shkak të rënies me 9.7% të raportuar në Poloni dhe 16.3% në Republikën Çeke, dy nga tregjet më të mëdha të sigurimeve në rajon. Në anën tjetër, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 6.9 miliardë euro, me një rritje prej 5%.

## Greqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Shoqatës së Kompanive të Sigurimit në Greqi (HAIC), tregu i sigurimeve u rrit me 2.2% në janar-prill 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Primet e shkruara bruto arritën në 1.3 miliardë euro në fund të muajit prill. Segmenti i Jetës u rrit me 7.4% dhe zë aktualisht 34% të tregut. Ndërsa segmenti i Jo-Jetës pësoi rënie me 2% dhe zë aktualisht 53.5% të tregut. Rënia e sigurimit të pronës me 16.4% u bë shkak për rënien e sigurimeve të Jo-Jetës në Greqi gjatë kësaj periudhe.

## 1/3 e siguruesve evropianë po përdorin Inteligjencën Artificiale në aktivitetin e përditshëm

[www.eiopa.europa.eu](http://www.eiopa.europa.eu)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale ka publikuar një përmbledhje të të dhënave të mbledhura nga analizimi i "Big Data" në tregun e sigurimeve në 28 shtetet anëtare. Synimi i studimit ishte mbledhja e provave në lidhje me përfitimet dhe rreziqet që lindin nga përdorimi i "Big Data" në linjat e sigurimit motorik dhe atij të shëndetit. Mes gjetjeve të studimit rezulton se mjetet e analizimit të "Big Data", si inteligjenca artificiale apo mësimi nëpërmjet makinerive përdoren në mënyrë aktive nga 31% e shoqërive, ndërsa 24% e shoqërive janë në fazë konceptimi.





---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)